

Foreign Account Tax Compliance Act – FATCA (*Ligji për Përputhshmërinë e Taksës mbi Llogarinë e Huaj*) është ligji amerikan për luftimin e evazionit fiskal jashtë territorit të SHBA dhe rekuperimin e të ardhurave fiskale. Specifikisht, FATCA i referohet Kapitullit 4, US Internal Revenue Code, miratuar nga Hiring Incentives to Restore Employment (HIRE) Act me 18.03.2010.

Qëllimi i këtij ligji është që t'i mundesojë SHBA marrjen e informacionit lidhur me llogaritë jashtë territorit dhe investimet me pronar përfitues taksapagues amerikan. Kjo do të thotë se subjektet raportuese të FATCA duhet të marrin, verifikojnë dhe transmetojnë informacion pranë Internal Revenue Service – IRS.

Banka e Tiranës sh.a. është rregjistruar pranë Internal Revenue Service (IRS) të SHBA-së dhe identifikohet me Global Intermediary Identification Number (GIIN): 62318P.99999.SL.008 nën statusin – Participating FFI (Institucion Financiar i Huaj Pjesëmarrës).

Ju bëjmë me dije se, duke filluar nga data 01.07.2014, Banka e Tiranës sh.a., në përputhje me statusin e zgjedhur, ka implementuar një procedurë të standartizuar të identifikimit të të gjithë klientëve të saj, individë dhe subjekte ligjorë, ekzistues dhe të rinj, duke respektuar dhe zbatuar legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe Ligjin për Përputhshmërinë e Taksës mbi Llogarinë e Huaj – FATCA.

Për më shumë informacion, ju lutem, referojuni faqes zyrtare të IRS në linkun:

<http://www.irs.gov/Businesses/Corporations/Foreign-Account-Tax-Compliance-Act-FATCA>

Dokumentacioni FATCA:

[W9](#)

[W8 - BEN](#)

[W8 - BEN - E](#)